

Rritje kapacitetesh në aftësimin e të rinjve

Raport vlerësimi



Shtator, 2023

Përmbajtja

Faqe

I. Përmbledhje	5
1.1 Hyrje.....	5
1.2 Qëllimi dhe objektivat e hulumtimit.....	6
1.3 Metodologjia e punës	6
1.3.1 Përzgjedhja e kampionit.....	6
1.3.2 Analiza e të dhënave	7
II. Rezultatet kryesore të hulumtimit.....	8
2.1 Demografia	8
2.2 Gjetje kryesore	8
2.2.1 Njohja me kuadrin ligjor për rininë	9
2.2.2 Infomacioni mbi Strategjinë Kombëtare të Rinisë.....	10
2.2.3 Aktivitetet rinore	10
2.2.4 Përfshirja e të rinjve në vendimmarrje.....	11
2.2.5 Koha online, qëllimet e lundrimit dhe nxitja e inovacionit digjital.....	12
2.2.6 Ndërveprimi online i të rinjve dhe aftësitë e tyre digjitale.....	13
2.6.7 Impakti i përfshirjes në projektin “Fuqizona: Rritje kapacitetesh rinore”	13
III. Konkluzione dhe rekomandime	14

Përmbajtja e tabelave

Faqe

<i>Figura 1. Fazat e ndjekura për kryerjen e procesit të hulumtimit:</i>	6
<i>Grafiku 1. Gjinia</i>	8
<i>Grafiku 2. Informacioni për kuadrin ligjor për rininë</i>	9
<i>Grafiku 3. Informacioni për SKR-në</i>	10
<i>Grafiku 4. Angazhimi në aktivitete rinore</i>	11
<i>Grafiku 5. Vlerësim mbi nivelin e burokracive administrative</i>	11
<i>Grafiku 6. Koha online</i>	12

Rritje kapacitetesh në aftësimin e të rinjve

Raport vlerësimi

©AMAD® 2023

“Ky raport vlerësimi u realizua në kuadër të projektit “FuqiZona: Rritje kapacitetesh rinore”, me mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Rinisë, AKR dhe Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, MSHRF. Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e AKR dhe MSHRF.”

I. PËRMBLEDHJE

1.1 Hyrje

Ashtu siç parashtrohet në kuadrin ligjor në Republikën e Shqipërisë dhe më konkretisht në ligjin nr. 75/2019 “Për rininë”, neni 4, pika 1 “mbështetja dhe fuqizimi i të rinjve bazohet në parimet e mëposhtme: a) parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit, të sanksionuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi; 2 b) parimin e mundësive të barabarta dhe garantimit të pjesëmarrjes së të rinjve në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse në fushat e arsimit, kërkimit shkencor, politikave financiare, punësimit, vullnetarizmit, mbrojtjes e përfshirjes sociale, shëndetësisë, kulturës, sportit, mjedisit, turizmit, drejtësisë, punëve të brendshme e të jashtme, integritit dhe të mbrojtjes, teknologjisë së informacionit, sipërmarrjes dhe në fusha të tjera që inkurajojnë zhvillimin e të rinjve; c) parimin e lirisë së organizimit të iniciativave rinore dhe të vetëqeverisjes së organizatave; ç) parimin e subsidiaritetit”.

Evidentimi i nevojave të të rinjë në një komunitet urban, suburban apo rural, kërkon pikë së pari njohja e objektivave dhe dëshirave të grupit të targetuar. Pikërisht për këtë arsye ky raport studimi vendos në zbatim një metodologji të përshtatur kërkimi në bazë të specifikave të orientuara nga grupi synuar për kampionim.

Nga analiza e gjetjeve të studimit parësor u evidentuan fushat me interes aktivizimi rinor, si edhe problematika që përbëjnë barrierat për këta të rinj. Kështu, ky raport studimi nxori në pah se interesi i të rinjve për të qenë aktivë në komunitet është i lartë. Ndër fushat më me interes në aktivizimin rinor ishin sportet, arti dhe letërsia, ndërkohë ato me më pak interes ishin aktivitete vullnetare të pastrimit të rrugëve në hapësirat e përbashkëta. Ndërkohë, për sa i përket barrierave me të cilat përballëshin të rinj, të cilat mesa u evidentua ishin relativisht të konsiderueshme, kryesuan përballjen me mentalitetin dhe stereotipet, sidomos në raport me çështjet gjinore.

Ky raport solli edhe rekomandimet përkatëse për mundësi ndërhyrjeje dhe përmirësimin e situatës problemore, duke nxitur më tej rritjen e kapaciteteve rinore, fuqizimin e të rinjve dhe aftësimin e tyre me potencial të rritur në punësim dhe mirëqenie socio-financiare, si edhe të inteligjencës sociale.

1.2 Qëllimi dhe objektivat e hulumtimit

Qëllimi i këtij raporti është të hulumtojë mbi mundësitë, nevojat dhe dëshirat e të rinjve për të qenë aktiv në komunitet, duke kontribuar në fuqizimin dhe mirëqenien e të rinjve dhe shoqërisë në Bashkinë e Rrogozhinës.


Ky hulumtim u zhvillua sipas këtyre objektivave:

- Të vihet në dukje angazhimi i të rinjve për të kontribuar në vendin e tyre;
- Të evidentohet impakti i aktiviteteve rinore;
- Të parashtrihen rekomandime zgjidhjesh të barrierave në fuqizimin e të rinjve të Rrogozhinës.

1.3 Metodologjia e punës

Për marrjen e një opinioni sa më të plotë, hulumtimi u fokusua në target grup-in e të rinjve dhe punonjësve rinorë, të cilët janë banorë në hapësirën gjeografike të Bashkisë së Rrogozhinës (Rrogozhinë, Lekaj, Gosë, Kryevidh, Sinaballaj).

Figura 1. Fazat e ndjekura për kryerjen e procesit të hulumtimit:



1.3.1 Përzgjedhja e kampionit

Faza e parë e përcaktimit të kampionimit ka të bëjë me zgjedhjen e njësisve primare të kampionimit (**PSU – Primary Sampling Units**). Për kryerjen e këtij studimi, u përcaktua si njësi primare kampionimi të rinj dhe punonjës rinorë në hapësirën gjeografike nën juridiksionin e Bashkisë së Rrogozhinës.

Si metodë hulumtimi u përdor ndërthurja e gjetjeve të grumbulluara përmes kombinimit të më shumë se një instrumenti kërkimi. Pikërisht për të patur një rezultat dheprojeksion gjetjesh sa më reale, si instrument matës u përdor:

- a) intervista e strukturuar, përmes *kanalit të komunikimit të drejtpërdrejtë*;
- b) takime me fokus grupe

Metoda e përzgjedhur për kampionimin e hulumtimit me instrumentin e parë, pra intervistën e strukturuar ishte shtresëzuar **SS (Stratified Sampling)**, me një përzgjedhje të thjeshtë në mënyrë rastësore, **SRS (Simple Random Sampling)**. Kjo metodë konsiston në përfitim të opinionit qytetar përmes metodës së stratifikuar dhe vjeljes së mendimit sipas kampionimit SRS.

Popullata	Banorë të Rrogozhinës
Grupi (strata)	Banorë në qytetin e Rrogozhinës, Njësia Administrative Rrogozhinë
Përzgjedhje të thjeshtë në mënyrë rastësore – SRS	Të rinj, kategoria moshore sipas legjislacionit në fuqi
Kampionimi	$\Sigma = a + b$, ku: a. 260 pyetësorë në gjimnazin “Haxhi Qehaj” b. 25 pyetësorë në hapësirat publike

Metoda e përzgjedhur për kampionimin e hulumtimit me instrumentin e dytë, pra takimet me fokus grupe u realizua me një kampionim më të targetuar:

- punonjës rinorë në Njësinë Administrative Rrogozhinë (9 persona);
- Qeveria e Nxënësve, gjimnazi “Haxhi Qehaj” (8 persona).

Nga ky hulumtim, u arrit një përfitim kampioni total prej **302 individë të intervistuar**, të rinj dhe punonjës rinorë, ku si parametër madhësie grup-moshe u përdor kriteri i moshës sipas përkufizimit të ligjit nr. 75/2019 “Për rininë”, neni 3, pika f) “Të rinj” janë personat, i ri ose e re, që kanë mbushur moshën 15 vjeç deri në 29 vjeç.

1.3.2 Analiza e të dhënave

Analiza e të dhënave në total, përmes instrumentit të pyetësorit dhe instrumentit të intervistës në fokus-grupe, u krye përmes përlllogaritjes së secilit cilësor, të zërave në pyetësor e të gjitha rezultatet e gjetjeve së bashku, në raport me numrin total të përgjigjeve të përfutuara.

Pra, $\frac{\sum x_1 + x_2 + x_3 \dots + x_x}{\text{Total}}$, ku **X** shënon rezultatet e përfutuara të një cilësori specifik, për zërin që po analizohet.

II. REZULTATET KRYESORE TË HULUMTIMIT


Nëpërmjet grafikëve, ky raport pasqyron rezultatet kryesore në total të hulumtimit, ku secili zë i grafikëve të mëposhtëm shënon të dhënat në total e të gjitha përgjigjeve të grumbulluara.

Në këtë hulumtim, sipas qëllimit dhe objektivave të tij, u evidentuan çështjet e mëposhtme:

2.1 Demografia

Nga projeksioni i analizës në lidhje me gjetjet biodata rezultoi se 55% e personave të intervistuar ishin meshkuj dhe 45% e tyre femra, kategoria moshore 15-29 vjeç (*pasqyruar në grafikun 1*).

Grafiku 1. Gjinia



2.2 Gjetje kryesore

Në këtë syth janë pasqyruar gjetjet totale të hulumtimit mbi informacionin që kanë të rinjtë dhe punonjësit rinorë mbi kuadrin ligjor për rininë, strategjitë kombëtare dhe incetivat për fuqizimin e të rinjve. Gjithashtu, projeksioni i gjetjeve evidenton aktivitetet me interes për të

rinjtë, synimet dhe objektivat e tyre, si edhe barrierat frenuese me të cilat ata përballen në komunitetin ku jetojnë.


Gjetjet në total të hulumtimit janë të pasqyruara sipas zërave të mëposhtëm.

2.2.1 Njohja me kuadrin ligjor për rininë

Fillimisht janë pyetur individët të përfshirë në dhënien e përgjigjeve të hulumtimit në lidhje me informimin bazë mbi ekzistencën dhe rregullimin ligjor për rininë. Sipas të dhënave të grumbulluara dhe analizës përkatëse, 302 pjesëmarrësit në hulumtim u pyetën se sa njohuri kishin mbi aspektin e rregullimeve ligjore për sa i përket mbrojtjes së të drejtave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse, krijimi i kushteve të nevojshme për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve, përcaktimin e funksioneve dhe kompetencave të institucioneve në nivel qendror dhe vendor, si dhe bashkëpunimi me organizatat që ushtrojnë veprimtari në fushën e rinisë.

Ky zë në projektionin e gjetjeve u strukturua i pikëzuar nga 1 deri në 5, ku 1=aspak i/e informuar dhe 5=shumë i/e informuar. Për të patur një projektion gjetjesh edhe në terma gjinorë, grafiku i mëposhtëm paraqet gjetjet përkatëse sipas përgjigjeve të femrave dhe meshkujve në këtë hulumtim. Projektioni grafik pasqyroj se ka një tregues të dukshëm për sa i përket informacionit bazë mbi ekzistencën e kuadrin ligjor mbi rininë, kjo e pasqyruar si tek femrat ashtu edhe te meshkujt, me një diferencë të vogël raporti mes tyre. (pasqyruar në grafikun 2).


Grafiku 2. Informacioni për kuadrin ligjor për rininë



2.2.2 Infomacioni mbi Strategjinë Kombëtare të Rinisë

Nga projekcioni i grafikut vihet re se të rinjtë kanë një informacion shumë bazik dhe nën mesatare mbi Strategjinë Kombëtare të Rinisë - SKR (pasqyruar në grafikun 3). Gjatë diskutimeve në fokus-grupet (të punonjësve rinorë dhe qeverisë së nxënësve) si edhe në pyetjet e hapura përmes pyetësorit u vërejt se nevojitej informim i orientuar me target-grupe për sa i përket objektivave të SKR-së. Këtë tregues e paraqet fakti se të gjitha përgjigjet e grumbulluara me pikëzim 4 dhe 5 kanë qenë nga individë (të rinj dhe punonjës rinorë) të cilët janë përfshirë nëaktivitetet e organizatës AMAD, përmes projektit “FuqiZona; Rritje kapacitetesh rinore”, mbështetur nga Agjencia Kombëtare e Rinisë dhe Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.


Grafiku 3. Informacioni për SKR-në



2.2.3 Aktivitetet rinore

Një ndër elementët e rëndësishëm në hulumtim ishte edhe aktivizimi i të rinjve që u bënë pjesë e këtij studimi. Projekcioni i analizës së të dhënave reflektoi se fushat e veprimtarisë kanë pak tregues sipas stereotipit gjinor kur bëhet fjalë të fusha si sport, art pamor, veprimtari letrare, muzikore, apo ndërgjegjësim shëndetësor (pasqyruar në grafikun 4). Kjo ndoshta për faktin edhe të infrastrukturës rinore që është funksionale në Rrogozhinë apo politikave gjithëpërfshirëse të zbatuara nga institucione të ndryshme. Ajo çka bie në sy është mungesa e pranisë së veprimtarive në fushën e inovacionit dhe digjitalizimit, ku veç 5.6% e vajzave dhe 3% e djemve janë shprehur se kanë interes dhe janë përfshirë në aktivitete që kanë të bëjnë me aftësi digjitale.

Grafiku 4. Angazhimi në aktivite rinore




Ky grup gjetjesh evidentoi edhe interesin e të rinjve, të cilët parashtruan nevojën për më shumë aktivitete aftësuese në:

- Leadership rinor;
- Etika e komunikimit online
- Dizajn dhe Marketing digjital
- Multimedia dhe prodhim kontenti online

2.2.4 Përfshirja e të rinjve në vendimmarrje

Për sa i përket përfshirjes së të rinjve në procese vendimmarrëse në përgjithësi dhe veçanërisht për sa i përket shërbimeve dhe investimeve në infrastrukturën rinore, 88% e vajzave, dhe 85% e djemve, pjesëmarrës në këtë hulumtim, u shprehën se nuk kanë qenë më parë të përfshirë në preocese vendimmarrëse. Përgjigjet e regjistruara me “Po” janë grumbulluar nga persona të cilët janë pjesë e qeverisë së nxënësve apo anëtarë të Këshillit Vendor Rinor (pasqyruar në grafikun 5).

Grafiku 5. Vlerësim mbi nivelin e burokracive administrative




Ndërkohë, të rinjtë shprehen se funksionojnë klubet rinore të debatit, por gjithmonë në kornizën e angazhimeve dhe organizimeve nga mësuesit brenda shkollës.

2.2.5 Koha online, qëllimet e lundrimit dhe nxitja e inovacionit digjital

Të rinjtë janë në kontakt të vijueshëm me mjetet dhe instrumentet e komunikimit / lundrimit online, pavarësisht nivelit të tyre socio-ekonomik. Për këtë arsye iu drejtua personave që u targetuan për hulumtimin dhe grumbullimin e gjetjeve në realizimin e këtij raporti se sa kohë ata/ato kalojnë online. Sipas projeksionit të gjetjeve duket se shumica e vajzave dhe djemve kalojnë rreth 1-2 orë online (sipas deklarimit të tyre), kjo për shkak të angazhimeve personale dhe/ose diktimit nga ana e autoritetit prindëror apo arsimor (*pasqyruar në grafikun 6*).

Grafiku 6. Koha online



Pyetur mbi **llojin e aktivitetit** të tyre online, rezultoi se thuajse të gjithë lundrojnë dhe janë aktiv në platformat e mediave sociale (Tik Tok, Instagram dhe shumë më pak në Facebook). Ndërkohë, një pjesë të mirë të kohës online e zënë edhe lojërat e ndryshme, apo veprimtaritë e projekteve shkollore të kërkuara nga mësuesit e lëndëve të ndryshme. Edhe informacioni duket se përfitohet po nga këto burime dhe kanale komunikimi.

Gjithashtu, punonjësit rinorë shprehen se falë këtij projekti nga organizata AMAD dhe mjedisit të ri të Qendrës Rinore (ku janë vendosur kompjuterë pune për të rinjtë),

Drejtoria e Rinisë në Bashkinë e Rrogozhinës dhe vetë Këshilli Rinor Vendor po bëjnë përpjekje nxitëse dhe motivuese për sa i përket inovacionit dhe start-upnë fushën e digjitalizimit të shërbimeve.

2.2.6 Ndërveprimi online i të rinjve dhe aftësitë e tyre digjitale

Nga projeksioni i gjetjeve cilësore evidentohet se ndërveprimi online i të rinjve duket se kryhet kryesisht për qëllime argëtimi se sa kërkimi informacioni. Një detaj tjetër i paraqitur ishte se burimi i informacionit të marrë shpesh ishte i korruptuar duke paraqitur kështu një ekspozim ndaj desinformimit dhe informacioneve të gabuara. Ndër të tjera u paraqit gjithashtu se kontrolli në lundrimin në internet nuk ekzistonte te kjo kategori.

Një ndër temat delikate të ekspozuar online dhe të konsideruara tabu nga shoqëria është edukimi mbi riprodhimin seksual, të cilën të rinjtë e kësaj grup-moshe duket se e marrin në një masë të konsiderueshme nga faqet pornografike, çka e bën informacionin të mos filtrohet në kuadër të etikës dhe marrëdhënies së respektit në ndërveprimin intim me tjetrin.

Hakimi i lojërave të ndryshme nga na tjetër duket se përbën një veprimtari të dedikuar online nga gjinia mashkullore, të cilët duken tepër të dhënë pas lojërve online.

Gjithashtu, dizajni dhe krijimi i avatarëve është trendi i tyre i preferuar, sipas projeksionit të gjetjeve, ku ata/ato shfaqin edhe talentin e tyre në këtë fushë, ku jo rrallë në diskutime shfaqin “konkurrencën” se kush e ka paraqitur avatarin e tyre më real, kush më të bukur, kush më kreativ etj.

2.6.7 Impakti i përfshirjes në projektin “Fuqizona: Rritje kapacitetesh rinore”

Pas zhvillimit të aktiviteteve trajnuese dhe mentoruese nga AMAD, u realizua një takim duke krijuar një fokus-grup të dedikuar me të rinj dhe punonjës rinorë, të cilët ishin pjesë e aktiviteteve të këtij projekti.

Për të sjellë gjetje cilësore dhe sasiore në qasje krahasuese i drejtuam të pranishmëve të njëjtat pyetje dhe rezultatet ishin shumë pozitive.

Kështu, mbi informacionin bazë rreth legjislacionit dhe SKR-së 98% e tyre iu përgjigjën saktë pyetjeve mbi objektivat e ligjit dhe SKR-së.

Lidhur me fushat e vëprimitarisë se ku ata duan të jenë më aktivë, kanë interes dhe motivim, kryesoi multimedia dhe ndërtimi i kontentit online. Zhvillimi i aktiviteteve sportive që thyejnë stereotipet gjinore, nxitje leximi dhe angazhim në nisma sociale ndërgjegjësuere u renditën gjithashtu si fusha me interes të madhe prej tyre.

III. KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

Nga hulumtimi “Baseline” mbi nevojat, potencialin, barrierat dhe sfidat e angazhimit rinor në Rrogozhinë, sipas analizës së të dhënave dhe projeksionit të gjetjeve sasiore dhe cilësore rezultoi se:

- Në fazën e parë të projektit ë rinjtë kanë pak ose aspak informacion mbi kuadrin ligjor për rininë dhe Strategjinë Kombëtare të Rinisë, ndërkohë që në fazën e dytë të projektit pas trajnimit në aftësi të buta dhe digjitale të rinjtë shfaqin interes të rritur, morivim dhe aktivizëm;
- Në fazën e parë të projektit ë rinjtë rezultuan të rinjtë janë prirur të kalonin kohë online me qëllim argëtimi dhe hulumtimi aktivitetesh sociale në platforma Tik Tok, Instagram, Snapchat etj., ndërkohë drejt përfundimit të fazës së dytë të zbatimit të këtij projekti duket se interesi dhe veprimtaria e tyre online është pasuruar me ndërtim kontenti multimedia. Gjithashtu, vërehet një ndërgjegjësime mbi kujdesin e lundrimit të sigurt online.
- Për sa i përket përfshirjes së të rinjve në vendimmarrje është pritur pozitivisht dhe në mënyrë aktive aktiviteti i organizatës AMAD për t’i trajnuar në shkrim projekti dhe prezantimi i këtij projekti nga vetë të rinjtë para përfaqësuesve të Bashkisë së Rrogozhinës.
- Të rinjtë kanë paraqitur kreativitet, kureshtje dhe seriozitet në praninë gjatë aktiviteteve për rritjen e kapaciteteve në aftësi të buta dhe digjitale, duke zbuluar/orientuar më mirë disa prej prirjeve të tyre në fushën e dizajnit.

Rekomandime:

- Për të vijuar zgjerimin e impaktit të këtij projekti nevojitet motivimi i duhur dhe vullneti i instancave vendore ku janë vendosur punonjësit rinorë, që të vendosin në zbatim punë konkrete në vijimin e rritjes së kapaciteteve rinore dhe orientimin e tyre në karrierë, duke qenë se Qendra Rinore e Rrogozhinës tanimë është totalisht në funksion;
- Të hartohet një strategji lokale (vendore) për të rinjtë;
- Të ketë më shumë incentiva investuese në infrastrukturën rinore në një zonë suburbane siç është Rrogozhina.
- Të kryhen takime me fokus-grupet të ndryshëm (prindër, mësues dhe punonjës në nivele drejtuese) për sa i përket gjithëpërfshirjes dhe nxitjes së sipërmarrjeve rinore.